

ILJAZ AGUSHI - APOSTULLI I SHQIPËRISË ETNIKE

Sangius heroum semen libertatis - Gjaku i heronjve është fara e lirisë

Muhamet PIRRAKU

Punim studimor

Në kujtesën historike të popullit shqiptar personaliteti i *Iljaz Haxhi Agushit* qëndron në pedestalin e *Altarit të Shqipërisë Etnike*: urtak, barmirës, paqekrijues, diplomat, udhëheqës trim e burrë shteti dinjitoz, me një parashikim politik kombëtar, *Fanar në Oqeanin Shqiptar* të trazuar nga jashtë dhe nga brenda. Në shëmbëlltyrën politike e luftarake të *Iljaz Agushit* i martirizuar, me vëllezër e me gjak, për tërësinë e *Shqipërisë Etnike*, kemi personalitetin kombëtar shqiptar të Kosovës më të ndjekur, më të anatemuar, më të përbuzur nga drejtuesit e organizatës komuniste kominterniste jugosllave në vitet 1941-1945, për faktin se ishte më i rrezikshmi për planet e tyre dëmtuese të çështjes shqiptare.

Ndonëse i lindur në një mjedis qytetar, në Prishtinë, ku turqishtja ishte futur për gjuhë familje, kurse shqipja kishte mbetur “*gjuhë për të marte*” -për pazare me fshatarësinë, *Iljaz Agushi* kishte dashuri jetike për *gjuhën e bilbilave të katundit*, siç i quante ai rapsodët popullorë. Kishte dashurinë llapushase për punën, dashurinë shqiptare më tipike për farefis, dashurinë për historinë e kombit, krenarinë për besën shqiptare dhe për trimërinë burrërore, gatishmërinë për sakrificë pa çmim për popullin, për lirinë e tij, për *lirinë e Shqipërisë - Një dhe të pandarë*. Populli e deshi dhe e mbiquajti “*Nana e fukarasë!*”

Për lirinë dhe për pavarësinë e *Shqipërisë* nga *Perandoria Osmane* punoi fuqimisht edhe i ati, *Xhemajl Agush Mehmeti*, i njohur në popull *Haxhi Xhemajl Aga*. Mirëpo, *Haxhi Xhemajli* përpjekjet për lirinë e *Shqipërisë* i mbështeti në Serbinë që tradhtoi *Isa Boletinin*, *Idriz Seferin*,

Begollët e Pejës, Ramadan Shabanët e Kjevës, Kryezitë e Gjakovës, e të mos flasim për dinarifët, mullasylët e hasahysenët të mbarë Kosovës. Ndaj, pasojat e luftërave ballkanike të Motit të hidhur 1912-1913, Haxhi Xhemajlin e rreshtuan, para syve të popullit, në tarafin e bejlerëve që “e shitën Kosovën!”. I zhgënjyer për bëmat, mblodhi familjen dhe iku në Konja, në Bursa e në Stamboll. Meqë një jetë ia kishte kushtuar shqiptarisë së Kosovës, nuk mund të hiqte dorë nga shqiptaria, nga varri i katragjyshit, Mehmet Mazrrekut në Malishevë, as nga varri i të et, Haxhi Agush Mehmetit, në Prishtinë. Dy djemtë e mëdhenj: Mustafën (1900) dhe Iljazin (i lindur më 14 prill 1903), të cilët mësimet fillore i mbaruan në Prishtinë, i dërgoi në Kolegjin e Diturive në Stamboll. Pasi e mbaruan me sukses të dalluar, i punësoi në Postë të Stambollit. Aty nisi aktiviteti politik i Iljaz Haxhi Agushit, lidhje më e sigurt midis Komitetit Shqiptar të Stambollit dhe Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës me seli në Shkodër. Kjo lidhje ndodhi edhe për faktin se Hoxhë Kadri Prishtina, kryetari i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës ishte dhëndër i Sylejman Pashës, tezak i Haxhi Agush Mehmetit.

Realisht, të dhënat burimore dhe kujtesa familjare dëshmojnë se Iljaz Agushi ishte lidhur me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në moshën 14-vjeçare, pikërisht në Klubin Kulturor Shqiptar të Stambollit. Këtu ishte betuar para Flamurit të Skënderbeut se “tërë qenien do t’ia kushtojë Atdheut stërgjyshor - Luftës për çlirimin e Kosovës dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike!” Më 1922, Hasan be Prishtina dhe Xhemajl be Sylejman Pasha, kushërinj të parë që tashti jetonin dhe vepronin në Tiranë, i shkruan Iljazit të ndikonte tek i ati, të kthente familjen në Prishtinë dhe të vazhdonte përpjekjet e hershme për shqiptarësinë e Kosovës dhe për Shqipërinë e lirë! Kërkesë për kthim në Kosovë Haxhi Xhemajli mori edhe nga Prishtina, pikërisht nga urtaku dhe dijetari i madh, Sheh Mehmet Sezai, të nënshkruar edhe nga Nazim Gafurri, nga ndera e burrërisë shqiptare të Prishtinës. Një Selam të pashkelshëm, në këtë drejtim, Haxhi Xhemajlit i kishte arritur edhe nga politikani madhor, Ferat be Draga, kryetar i Organizatës Politike Kombëtare “Xhemief” (Bashkimi). Kësaj kërkesë unanime nuk i bishtnoi as xhaxhai i Iljaz Agushit, urtaku Murat Aga dhe, pa vonesë, Familja Agushi u kthye në Prishtinë, në shtëpitë dhe në një pjesë të pronave të veta.

Vërtet, Familja Agushi nga fundi i shekullit XIX mund të konsiderohej Derë e katërt e Prishtinës pas pinjollëve të Gjinollajve, Derës së Muftilerëve (të bijtë e Emin Agës së Sllatinës së Moravës së Epërme) dhe Derës së Sulejman pashë Prishtinës. Në ngritjen e Familjes Agushi u shqua i vëllai i Xhemajlit dhe i Muratit, Mehmet Agush Mehmeti, tregtar

dhe patriot i shquar i helmuar nga turqit në Selanik. Këtu qëndronte misteri dhe shtytja intime e *Haxhi Xhemail Agushit* për hakmarrje kundër robëruesit osman qoftë edhe në mbështetje të Serbisë.

Për “rehabilitimin” e shpejtë politik kombëtar të *Haxhi Xhemajl Agushit*, pas riatdhesimit në Prishtinë dhe në Kosovë, ndikuan personalitetet e përmendura më lart. *Haxhi Xhemajl Aga* përnjëherë u hodh në lëvizjen politike kombëtare të “*Xhemietit*” dhe u zgjodh deputet i kësaj partie për Prishtinë, në *Parlamentin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene*, krahas *Nazim Gafurrit*. Mirëpo, respektin e plotë politik kombëtar para popullit *Haxhi Xhemajli* do ta arrijë pas lidhjes së krushqisë së re me *Derën e Sylejman pashë Prishtinës*. *Iljaz Haxhi Agushi* do të martohet me të bijën e *Xhemajl be Sylejman Pashës*, me tipare stërgjyshore drenicare, një si *Leonidi i Termopiles shqiptare në Përpallac – Mërdar*, në tetor të vitit 1912, kundër sulmit të ushtrisë pushtuese të Serbisë në Kosovë.

Dëshmori i kombit, *Apostull i Shqipërisë Etnike - Iljaz Haxhi Agushi*, shumë herët u shqua me urti politike, me dije dhe me dashuri për njerëzit. Fillimisht punoi rentier, udhëhoqi ekonominë familjare, administroi *Vakëfin e Bashkësisë Islame të Prishtinës* dhe ndihmoi të atit në detyrat që i dilnin si përfaqësues shumë i respektueshëm midis masave dhe *Klubit të Deputetëve Shqiptarë në Parlamentin e Jugosllavisë*. Në vitet 30 *Iljaz Haxhi Agushi* e gjejmë anëtar të *Këshillit Drejtues të Organizatës së Myslimanëve për viset shqiptare jashtë Shqipërisë londineze* dhe drejtor të *Vakëfit të kësaj Bashkësie me seli në Shkup*, e cila administronte viset shqiptare etnike dhe historike jashtë kufirit të *Shqipërisë londineze*. Në vitin 1936 *Iljazit* i vdiq gruaja, duke ia lënë katër djem, fare të mitur, të cilët do t’ia rritë motra *Behixhe*. Kurrë më nuk u martua. Iu përkushtua kryekreje politikës kombëtare për çlirimin e Kosovës dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike. Pas vdekjes së t’et, më 1938, *Iljaz Haxhi Agushi* u zgjodh përfaqësues në *Parlamentin e Jugosllavisë* për viset e *Ferizajt*. Nga ky moment fillon karriera politike e mirëfilltë e *Iljaz Haxhi Agushit*.

Ndonëse relativisht i ri, por i burrëruar para kohës, e shqoi dinjiteti i panëpërkëmbur, me fjalë petake, me një aftësi të jashtëzakonshme kohezive për lidhjen përreth vetes të deputetëve dhe të personaliteteve politike shqiptare me përkatësi partiake të ndryshme. Kjo për faktin se *Iljaz Aga*, siç e quante populli, *veprimtarinë e tij politike praktike e mbështeti vetëm mbi shqiptarinë si partishmëri luftarake*. Në historinë shqiptare të Kosovës, përkatësisht të *Shqipërisë Lindore në Përgjithësi*, nuk

mund të gjendet asnjë personalitet që kishte përreth vetes më shumë krerë, më shumë ulema, më shumë tregtarë, më shumë industrialistë, më shumë politikanë, më shumë nxënës e studentë, më shumë fukarenj e të sëmurë, më shumë nevojtarë – pra, më shumë mbështetës. Është e vërtetë se i ati, deputeti *Haxhi Xhemajl Aga*, i mbështetur në krerët e *Llapit*, të *Gallapit*, të *Rrafshit të Kosovës* dhe të *Drenicës*, ishte bërë digë kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, dhe mbështetja më fisnike e *Ferat be Dragës*. Pas këtij aktiviteti qëndronte fuqimisht *Iljaz Aga*, i cili, nga mesi i viteve 30, ishte forca bashkuese që ia ruante edhe *Ferat be Dragës* përkrahësit dhe bashkëlufëtaret në *Frontin e Përgjithshëm të Rezistencës Politike Shqiptare Antiserbe*.

Nga fillimi i pjesës së dytë të prillit vitit 1941, ushtria e pushtuesit fashist italian e ngriti Komunën e Prishtinës me kryetar e nëpunës serbë. *Iljaz Haxhi Agushi*, në mbështetje të dijetarit e udhëheqësit shpirtëror, *Sheh Mehmet Sezait*, ftoi *Llap e Gallap*, *Rrafshin e Kosovës* dhe *Drenicën*. Mbi 30 mijë veta, edhe me armë jetike, e pushtuan Prishtinën. Para syve të ushtrisë pushtuese italiane, i nxori nga zyra kryetarin dhe nëpunësit serbë. Komunën ua besoi dy burrave të fortë: *Mustafa Abitit* dhe *Ahmet Salihut*, ish-bashkëveprimtarë më të afërm të *Nazim Gafurrit*. Në rrethana të një entuziazmi mbarëpopullor, nën valëvitjet e *Flamurit të Skënderbeut*, shpalli të ngritur edhe *Prefekturën e Prishtinës*. Populli *Iljazin* e emëroi prefekt me aklamacion. Dhe, me një nguti, duke e bërë edhe natën ditë, *Iljaz Agushi* i ngriti komunat në *arealin e Prishtinës*, të *Fushë-Kosovës*, të *Drenicës*, të *Shtimes*. Shkoi në Mitrovicë dhe komandantit gjerman ia shtroi kërkesën gjithëshqiptare për bashkimin e *Mitrovicës* dhe të *Tregut të Ri* me *Shqipërinë* mëmë që po ribashkohej. Prej andej arriti në *Ferizaj* dhe në një miting mbarëpopullor, nën valëvitjet e *Flamurit Kombëtar*, e ngriti *Nënprefekturën e Ferizajt*.

Nga këtu *Iljazi* shkoi në *Prizren*, ndihmoi në konsolidimin e pushtetit shqiptar në *Prefekturë* dhe kërkoi nga *Komanda gjermane për Zonën e Kosovës të urdhëronte bashkimin e viseve të Gjilanit, të Llapit, të Vushtrrisë e të Mitrovicës me Shqipërinë*. Nga andej erdhi në Gjilan, të cilin e synonte *Bullgaria fashiste*, dhe nën valëvitjet e *Flamurit Kombëtar* vendosi nënprefektin dhe kryetarët e komunave në pjesën më të madhe të *Anamoravës*. Edhe këtë nënprefekturë, si më parë atë të *Ferizajt*, ia bashkoi *Prefekturës së Prishtinës*, realisht *Shqipërisë* që po ribashkohej me shumë vështirësi.

Prefekti i Prishtinës, *Iljaz Haxhi Agushi*, pa vonuar i përtëriti lidhjet e ngushta me *Komitetin e Kosovës të Bedri be Pejani* në Tiranë, kurse në

nëntokën e propagandës sekrete italiane *Iljazi konsiderohej shqiptari numër Një i kategorisë "Grande Ufficiale"*, karshi *Ferat be Dragës që konsiderohej numri Një i shqiptarëve "Grand Corobne"*. Patrioti *Iljaz Haxhi Agushi* njëkohësisht vuri lidhje me bashkëpunëtorët nga periudha e veprimtarisë në *Kryesinë e Bashkësisë Islame në Shkup*, aktivistë të *Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare për vise të Shkupit, të Kumanovës, të Tetovës, të Dibrës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Strugës, të Ohrit e të Manastirit* dhe kërkoi nga ata të forconin aktivitetin politik për bashkimin e atyre viseve me *Shqipërinë*. Ithtarët e *Iljaz Haxhi Agushit*, të bashkuar me rininë studentore përparimtare kombëtare dhe komuniste, organizuan *Demonstratën kombëtare historike të Shkupit*, në të cilën mori pjesë i tërë qyteti e rrethina, të gjithë me *plisa të bardhë shqiptarë*, me kërkesën sublime: "*Shkupi asht i yni...!*"

Punën e parë dhe më të madhe që *Iljaz Agushi* bëri për dëshmimin e shqiptarësisë së Prishtinës, në këtë kohë kryesisht shqiptare turkofone në familje, ishte hapja e *Liceut "Sami Frashëri"*. Ia siguroi kushtet fillestare për punë, me mjete të veta. Nën patronazhin e *Iljazit* do të mbahet shfaqja e parë kombëtare shqiptare në Prishtinë, përgatitur nga nxënësit e këtij gjimnazi. Ka mbetur në kujtesën historike një moment frymëzues. Skena kur një vajzë me gjergjef në duar po zhdrivillonte *Flamutin Shqiptar*, irritoi kapitenin fashist, arbëreshin *Antika*. Patrioti syshqiponjë, *Iljaz Agushi* iu kundërvu pa hezitim: "*Zoti Kapiten! Mos provoni të dilni duke shkelur mbi Flamur...! Kush e shkelë flamurin e shqiptarit atë do ta paguaj me kokë...*" Ky incident, kështu, u bë pjesa më e rëndësishme e shfaqjes së parë në gjimnazin "*Sami Frashëri*".

Meqë përpjekjet e *Iljazit* kishin mbështetjen e gjithanshme të masave, për bashkimin e të gjitha viseve shqiptare jashtë Shqipërisë londineze me *Mbretninë Shqiptare*, do të nominohet anëtar i *Kabinetit Qeveritar të Mbretnisë Shqiptare* nën kurorën mbretërore të Italisë, më 3 dhjetor 1941. Për kryeministër ishte nominuar *Mustafa Merlika – Kruja*, bashkëveprimtari më besnik i *Hasan Prishtinës* nga *Komploti i Taksimit*, në fillim të vitit 1912, për organizimin e *Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare për çlirimin, autonominë dhe Pavarësinë e Shqipërisë*. Pasi *Iljazi* kishte përvojë të gjatë në drejtimin dhe administrimin e ekonomisë me interes shoqëror e shtetëror, do të emërohet *Ministër Sekretar Shteti për Punë Botore* në *Kabinetin e Mustafa Krujës*. Ishte kjo ministri e rëndësishme për punët publike të vendit. Këtë postë do ta mbajë edhe në tri kabinetet qeveritare shqiptare deri me kapitullimin e Italisë fashiste. Në dy qeveritë e *Maliq be Bushatit* dhe në qeverinë e *Ekrem be Libohovës*, nga mesi i janarit deri në mesin e shtatorit 1943, krahas postit të *Ministrit*

për *Punë Botore*, *Iljazi* ishte edhe *Nënkryeministër* dhe *Zëvendëskryeministër* i *Mbretnisë Shqiptare*, ishte pra njeriu i dytë publik në Shqipërinë që vepronte për ribashkimin e të gjitha vendeve shqiptare etnike dhe historike.

Vërtet, periudha kur *Iljaz Haxhi Agushi* ushtroi detyrat shtetërore të përmendura, është koha kur pjesa më e madhe e tokave shqiptare, për të parën herë, përjetoi të mirat e shtetit kombëtar në mundësi: në fushë të ndërtimit, të shëndetësisë, të arsimit, të informimit, të bonifikimit të tokave, të komunikacionit tokësor, të telekomunikacionit, të zhvillimit ekonomik, të planifikimit hapësinor kombëtare shtetëror etj., por këtu nuk do të ndalemi gjerësisht. Këtu, megjithatë, është momenti historik të konstatojmë se *Iljaz Haxhi Agushi* ia dhuroi Ferizajt *xhaminë madhështore*, pranë kishës ortodokse dhe kështu këtij qyteti, qendër administrative, dhe rrethinës ia faktografoi identitetin shqiptar. Ishte *Eminenca e kaltër për Tokat Shqiptare të Çliruara*.

Vërtet, *Iljazi*, falë guximit dhe patriotizmit të kulluar, e shfrytëzoi maksimalisht postin e *Ministrit të Punëve Botore* dhe postin e për organizimin dhe për fuqizimin e *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës* nga fundi i vitit 1941, përkatësisht nga fillimi i vitit 1942 dhe u bë kurrizi i përpjekjeve për ribashkimin e plotë administrativ shtetëror të *Shqipërisë Etnike*. Kjo qartë shihej nga fjalimet e tij në *mitingjet popullore* të shkurt-marsit 1942, në Prishtinë, në Ferizaj, në Gjilan, në Pejë e në Prizren. Në këto mitingje u lidh, me aklamacion, “*Besa-Besën*” tradicionale shqiptare për t’i dalë zot plëngut, tokës stërgjyshore. Për këto qëllime e vuri në shërbim tërë pasurinë përralore që kishte *familja Agushi*. Përpjekjet patriotike të *Iljaz Haxhi Agushit* në *Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës* dhe përpjekjet për ribashkimin e *Shqipërisë*, *Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosmet* do t’i kualifikojë “*punë kuislingu*” në shërbim “*të qeverisë kuislinge të Mustafa Krujës*”?! Ndërkaq, në mars të atij viti, do ta etiketojë për “*tradhtar të popullit shqiptar*”, e në maj të vitit 1942 do ta quajë: “*pjesëtar të kolonës së pestë*”?! Dhe, *Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosmet* në korrik të vitit 1942, në *Iljaz Agushin* shihte korifeun për “*Shqipërinë e Madhe*”, nocion ky serb shovinist i fundshekullit XIX. Njëkohësisht, nëntoka shqiptare profashiste italiane, përmes zyrtarëve të tarafit “*Parti Kombëtare Fashiste Shqiptare*”, ia përgjonte edhe bisedat private, madje edhe ato më intime me miqtë më besnikë. Janë dhjetëra raporte të *Muhamet Çetës*, të *Muharrem Xhedikut* dhe të *Dervish Bejlerit*, dërguar *Kolë Bib Mirakajt*, ku *Iljaz Agushi* portretizohej personalitet “*me mentalitet të vjetër*”, “*bejlerë-feudal*”, “*islam proturk*”(!?) dhe si pengesë kryesore në Kosovë kundër aspiratave nazifashiste të *Musolinit* e të

Hitlerit për Rendin e Ri evropian. Kërkohej eliminimi i tij nga skena politike dhe pushtetore, për të lehtësuar zëvendësimin e kuadrove kombëtare të Iljaz Agushit në komuna, në nënprefektura dhe në prefektura, me kuadro të përkushtuara nazifashizmit, katolicizmit dhe kurorës mbretërore të Italisë.

Nga shtatori i vitit 1942 kërbaçin serb komunisto-çetnik dhe italian fashist për të qëlluar mbi ndershmerinë, mençurinë, patriotizmin dhe gatishmerinë për sakrificë pa çmim të *Iljaz Haxhi Agushit*, për kombin shqiptar, e mori në dorë komandanti i *Shtabit të Përgjithshëm të Aradheve Partizane të Kosmetit*. Meqë PKJ-ja në *Iljazin* shihte drejtuesin e rrymës shqiptare për ribashkimin e *Shqipërisë Etnike*, me qëllim të “*merrnin pushtetin nga okupatori në momentin e thyerjes*” së tij, komandanti partizan në nëntorin e vitit 1942, *Iljazin* e shihte në krye të listës së “*reaksionarëve*”, themelues të “*Frontit të Kreshnikëve fshatarë për Mbrojtjen Kombëtare*”, ndaj e shante marrëzisht: “*E juve, qen të fëlliqtë dhe shërbëtorë të okupatorit: Iljaz, Sefedin, Rifat, Xhevat Begolli, Kajtaç, A. Dush. Pal Lumez, Kryezi, S. Goran, F. Dragë, K. dhe P. Bib(...), nuk do të ketë birë në globin tokësor ku do të mund të fshihi nga gjyqi i popullit...!*” Koha e vërtetoi se cili kishte qenë në pozitën e “qenit besnik”, në shërbim të të huajit, të varrmihësit të lirisë së Shqipërisë.

Të dhënat burimore arkivale dhe publicistike, por edhe kujtesa historike e popullit, flasin qartë se *Iljaz Haxhi Agushi* dhe qeveritë shqiptare në të cilat ai përbënte gjithnjë më shumë se telin e dytë të çiftelisë, u përpoqën dhe vepruan politikisht e ushtarakisht për realizimin e ribashkimit të Shqipërisë tërësore dhe neutrale, në shembullin e *Suedisë* dhe të *Turqisë*. Angazhimi i *Iljaz Agushit* për ndriçimin e *Masakrës serbo-mazeze të Bihorit* të 5/6 janarit 1943 dhe të *Kalljes së Çarshisë së Pejës nga italianët* për interesa të PKJ-së serbe albanofobe, më 21-22 mars 1943, e shtoi besimin e popullit ndaj Tij.

Për ribashkimin dhe mbrojtjen e pjesës shqiptare etnike dhe historike të *Rozhajës*, të *Bihorit*, të *Sjenicës* dhe të *Tregut të Ri*, *Iljaz Agushi*, me para të tij, me shpenzime familjare, rekrutoi dhe armatosi 6000 vullnetarë, *Kreshnikë të veshur me këmisha të vdekjes, për tërësinë e Njesisë etnokulturore dhe gjeopolitike të Shqipërisë*. Shkallën e vendosmërisë së *Iljazit* për këto qëllime ilustronte mirë dueli verbal i Tij me komandantin italian, gjeneralin *Roto*, që komandoi *Kalljen e Pejës* - sipas kurthit të *Organizatës së PKJ-së* me lidhje të pista kurvërie: “*Zotëri! Këta serbët kanë vajza të mira dhe ua dhanë edhe Juve, kurse ne i kemi të mira, por i kemi vetëm për veti...!*”

Angazhimi për ndriçimin e *Tragjedisë së Bihorin* dhe të *Pejës*, si masë për të parandaluar skenat e tilla serbe çetniko-komuniste të llahtarshme, në mbështetje të ushtrisë dhe të karabinierisë italiane, bëri që *Iljaz Haxhi Agushi* të shikohet si *Mesi* për shqiptarët dhe *shqiptarinë e Kosovës* dhe të *Sanxhakut*, promotor i *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës* në *Shalë të Bajgorës*, në *Llap* e në *Gallap*, në *Kosovën Lindore* dhe në mbarë *Iliridën sot administrimin nën e Maqedonisë*, kukullshtet aktual kominternisto-amerikano-evropian. Me rastin e riemërimit në postin e *Ministrit të Punëve Botore* dhe të *Nënkryeministrit në Qeverinë e Ekrem Libohovës*, i cili i përkiste organizimit politik ballist të *Mid'hat Frashërit*, gazeta *Tomori i Vogël*, më 13 maj 1943, theksonte se *Iljaz Haxhi Agushi* “është një prej elementeve më shpresëdhënëse dhe më të kulturuar” të Kosovës. Koncepti *Kosovë*, në këtë periudhë, nënkuptonte të gjitha viset shqiptare të aneksuara *Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene*, më 1919, në *Versajë*.

Se madhori i kombit, *Iljaz Haxhi Agushi*, ishte personi më i përkushtuar dhe më me kredibilitet të paluhatshëm në kabinetet qeveritare shqiptare të kohës për realizimin e tërësisë së Shqipërisë me çdo çmim, kuptohet nga të dhënat që do të përmendën shkurtimisht. Nga pjesa e dytë e korrikut 1943 shihej qartë se kapitullimit të Italisë fashiste po i numëroheshin ditët. *Iljaz Agushi*, i përkiste lagjes së personaliteteve shqiptare të rralla që përpiqeshin për krijimin e *Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar Shqiptar* të të gjitha drejtimeve politike e luftarake shqiptare anti-nazifashiste. Vazhdimisht, dhe gati gjysmë legalisht, ndikoi në lirin e komunistëve shqiptarë antifashistë nga burgjet në Prishtinë, në Prizren, në Shkodër e në Tiranë. Madje, dy herë e pritë, në *Kryeministri*, të deleguarin e komandantit partizan të Kosovës patriotin antifashist *Hajdar Dushin* dhe, së fundi, në vigjilje të dorëheqjes së *Benito Musolinit*, realizoi një takim me *Fadil Hoxhën*, në *Ferizaj*. Me këtë rast *Iljazi* ia tërhoqi vërejtjen *Fadilit*, përfundimisht: “*Asnjë lidhje me Beligradin popullin shqiptar nuk do ta shpjerë në liri....!*”

Ishte ky mësim nga përvoja historike e kombit shqiptar. Patrioti sakrifikues i pashoq për kohën, *Iljaz Agushi*, e dinte se *Lëvizja Antifashiste* ishte e drejtë dhe i ofronte *Lëvizjes Nacionalçlirimtare Shqiptare të Fadil Hoxhës dhe të Enver Hoxhës* përkrahjen politike dhe ndihmën materiale të pa numëruar, me kusht që *LNÇ-ja* të zhvillohej politikisht dhe ushtarakisht unike për mbarë hapësirën e *Shqipërisë Etnike*, me një qëndër politike dhe me një komandë ushtarake për tërë *Shqipërinë Etnike*. Kërkonte nga ata që *Çështja shqiptare e pazgjidhur të ndërkombëtarizohej si çështje gjithëshqiptare dhe jo si çështje krahinore parciale*.

Madhori i kombit, *Iljaz Agushi*, për këtë mision kishte edhe bekimin e misionarit ushtarak anglo-amerikan në Shqipëri.

Se *Iljaz Haxhi Agushi* dhe qeveritë në të cilat ai kishte fjalën pas *Njëshit të shtetit*, shestuan dhe trasuan rrugën e pavarësisë dhe të neutralitetit të *Shqipërisë tërësore*, shihet nga *Thirrja* që *Iljazi*, në emër të qeverisë, ia drejtoi popullit shqiptar, më 26 korrik 1943, një ditë pas dorëheqjes së *Benito Musolinit*, duke e quajtur atë akt “*nji ngjarje të brendshme italiane*”. Në emër të kreut shtetëror të *Shqipërisë Etnike*, *Iljaz Agushi* i ftonte shqiptarët të rrinin “*të qetë secili në krye të detyrës edhe të punës së vet*”, ngase “*Qeveria ka marrë masat e nevojshme për sigurimin e rendit dhe të qetësisë botore*”.

Këtu duhet të theksohet fakti se në *Marrëveshjen e Mukjes*, të 1-2 gushtit 1943, midis forcave politike e ushtarake të LNÇSH-së antifashiste kominterniste dhe atyre demokratike të *Ballit Kombëtar* dhe të *Legalitetit*, *Iljaz Haxhi Agushi* pati rol të madh nga pozita e politkanit pastër kombëtar. Me këtë rast u formua “*Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë*”, ëndërr jetike e *Iljaz Agushit*. Në Tiranë pati mbështetje, si në vetën, në: *Mustafa Krujën*, *Hasan Dostin*, *Ejup Kazazin*, *Qazim Koculin*, *Lec Bushatin*, *Avni Gjilanin* etj. Kurrë nuk e fshehu simpatinë ndaj *Mbretit të shqiptarëve - Ahmet Zogut*, por një lidhje shumë intime lirifarkëtuese kishte me *Fejzi Alizotin*, me *Bahri Omarin*, me *dr. Skënder Muçon* dhe me *Hysni Lepenicën*, dy të fundit ballistë të shquar, ndjekës të betuar të *Mid'hat Frashërit*.

Organizata e PKJ-së për Kosmet, duke pasur njohuri të plota se *Iljaz Agushi* ishte forca motorike e Kosovës e më gjerë, që siguroi *Vendimet Historike të Mukjes*, pa vonuar do t'i thërrasë popullit shqiptar të Kosovës e më gjerë, të mos i dëgjonin “*tradhtarët e popullit shqiptar: Iljaz Agushin (...), ish-shpiun jugosllav, kurse tashti shërbëtor i okupatorit...*”(?!). Kjo ishte rrenë propagandistike e hapur. *Iljaz Agushi* gjithnjë larg i të qenit spiun dhe shërbëtor i okupatorëve. Madje, *Komandanti partizan i Kosmetit* nuk ngurroi të thellonte shpifjet komuniste dhe të hidhte baltë mbi personalitetin politik shqiptar midis më të dinjitetshmëve të kohës : “*Jo ore Agushoviq nuk i hamë ma ato kokrra ullini*”, sepse lirinë e popullit shqiptar ka për ta sjellë LNÇ-ja e Kosmetit me “*Shtabin kryesor në ballë. Kjo rrugë asht rruga qi po ndjekin vllaznit t'onë në Shqipni*”(?!).

Largpamësinë politike kombëtare antifashiste të kultivuar nga *Kabineti Libohova - Agushi* pasqyron përmbajtja dhe mesazhet e dy dokumenteve të fundit. Në *Thirrjen* e nënshkruar nga kryeministri *Libohova*,

më 9 shtator 1943, drejtuar kombit me rastin e kapitullimit të *Italisë Fasiste*, theksohej: “Unë dhe bashkëpunëtorët e mij gemë të bindur se, në përleshjen njerëzore që po zhvillohet, Shqipëria nuk mund të lozte asnjë rol”, andaj qëndruam neutralë ndaj blloqeve ndërluftuese, me qëllim që, në momentin e duhur, “me një zë të vetëm të mbrojmë të drejtat” tona legjitime. Në vazhdim ftonte “të gjithë sa kanë gjak shqiptari qysh prej Prishtine në Konispol dhe qysh prej Ulqini në Tetovë, të shtrëngohen rreth Flamurit” kombëtar, sepse “shpëtimi i ynë qëndron në bashkim, rregull dhe dishiplinë!”

Dokumenti tjetër është *Vendimi i Qeverisë së Mbretnisë së Shqipërisë*, i aprovuar nën kryesinë e *Iljaz Haxhi Agushi* - për pavarësinë dhe neutralitetin e shtetit shqiptar në shtrirje të arealit etnik e gjeopolitik të Shqipërisë, i cili, këso kohe, konsiderohej se ende mbulonte rreth 74 000 km² të tokës ballkanike. Ky vendim njëkohësisht ishte edhe *Informatë publike* për kombin dhe për botën, në të cilën saktësohej:

“Sot (më 11 shtator 1943), Këshilli Ministror në Mbledhjen e jash-tëzakonshme, nën kryesinë e Shkelqeses *Iljaz Agushi*, Nen-Kryeministër e Zav. Kryeministër, shqyrtoi gjendjen e Shqipërisë me kapitullimin e ush-trisë italiane e me arritjen në tokën t’onë të ushtrive gjermane.

Mbasi u konstatue njoftimi se ushtritë gjermane vijnë në tokën shqiptare si mike vetëm për nevojë të luftës,

Mbasi u konstatue se Reich-u i Madh Gjerman e shikon me simpati një Shqipëri independente me kufijë që i caktojnë gjuha e gjaku dhe asht e vendue me e mbrojtë,

Këshilli Ministrues njizani Vendosi:

- 1) Shpallet pamvarësia e plotë Shqiptare,
- 2) Qeverija merrë të gjitha pushtetet sovrane deri sa të zgjidhet Asambleja e re,
- 3) Krijohen Ministrija e P. të Jashtme dhe Ministrija e Mbrojtjes kombëtare,
- 4) Riorganizimi i fuqive t’armatosuna shqiptare do të fillojë me njëherë,
- 5) Rregulli botuer do të mbahet me çdo kusht”.

Çka mund të bënte më shumë *Iljaz Haxhi Agushi*, në rrethana të një konflikti ndërkombëtar të *Fuqive Imperialiste për dominim në botë*? Ur-taku *Mulla Hysen Statovci*, poet bejtexhinj dhe udhëheqës shpirtërorë, duke komentuar këtë akt politik dhe diplomatik, më 1982, do të kons-

tatojë: “*Iljaz Agushi e përmbushi betimin; Bashkimin e Shqipërisë cep me cep të saj...!*”

Kabineti Libova – Agushi, më 14 shtator 1943, qeverisjen e Shqipërisë ia dorëzoi Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, në përbërje: Rexhep Mitrovica, Xhafer Deva, Lef Nosi, Mehdi Frashëri, Patër Anton Harapi dhe Fuad Dibra etj. Ky Këshill duhej të realizonte zgjedhjen e përfaqësuesve të prefekturave për Asamblenë Kombëtare të Shqipërisë në arealin etnik dhe historik shqiptar.

Po më 14 shtator 1943, në Prizren u mbledh Këshilli Nismëtar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, kurse Kuvendi Themelues i Lidhjes u hap më 16 shtator 1943, nën kryesinë e dijetarit urtak, Musa Efendi Shehzade të Prizrenit, mik i ngushtë i Sheh Mehmet Sezait dhe i Iljaz Agushit, dëshmor i kombit i Nëntorit të Përgjakur ‘44. Prishtinën, në këtë Kuvend, e përfaqësonte edhe i vëllai i Iljazit, Jusuf Haxhi Agushi, i lauruar në filozofi në Universitetin e Zagrebit, kurse vëllai i madh i tij, Mustafë Aga, me autoritet suprem në Prishtinë e në rrethinë, ishte personi i dytë në Degën e Lidhjes për Prefekturën e Prishtinës, pas kryetarit Shyqyri be Haxhi Ramadanit, bamirësi i kombit, e të dytë dëshmorë të kombit të Nëntorit të Përgjakur ‘44.

Të konstatojmë edhe një fakt: Pjesa më e madhe e delegatëve të Kuvendit Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin bashkëveprimtarë shumëvjeçarë dhe miq të Iljaz Haxhi Agushit. Së këndejmi, komandanti partizan i Kosmetit, duke denoncuar Lidhjen e Dytë të Prizrenit si organizatë nazifashiste shqiptaromadhe, atë e quante *instrument të Iljaz Agushit*, të Xhafer Devës, të Sefedin Begollit e të Tahir Kolgjinit “*me kompaninë*”. Madje komandanti partizan në Iljazin e në Tahirin shihte inspiruesit e nacionalizmës shqiptare.

Në këtë pikë, kishte të drejtë komandanti partizan, Fadil Hoxha. Ndonëse ishte bërë ndërrimi i sistemeve okupuese nga ai fashist italian në atë nazist gjerman, Iljaz Haxhi Agushi, as Tahir Kolgjini, nuk mund të nxirreshin në margjina të politikës shtetërore shqiptare. Iljazin, madje, e gjejmë korife në listën e 29 përfaqësuesve të Prefekturës së Prishtinës për Asamblenë Kombëtare të Mbretnisë Shqiptare, më 16 tetor 1943. Organizata e PKJ-së dhe Shtabi i Përgjithshëm i Aradheve Partizane të Kosmetit e përcillnin me kujdes e vendosmëri aktivitetin politik të Iljaz Haxhi Agushit dhe ishin bindur se tashti Ai, në qarqet pushtetore dhe ushtarake, kishte edhe më shumë përkrahës, më shumë ithtarë, më shumë bashkëluftëtarë për sendërtimin e idesë për Shqipërinë tërësore. Së këndejmi, morën vendim ta likuidonin.

Strategjia për likuidimin e *Iljaz Agushit* u përpunua në *Ferizaj*, në banesën e *Pjetër Cicës*, ish-komandant ushtarak i *Ushtrisë së Mbretnisë Shqiptare* dhe tashti *Nënprefekt i Ferizajt*, i lidhur ngushtësisht me *Organizatën e PKJ-së* dhe me komandantin partizan të *Kosmetit*, *Fadil Hoxhën*. Janë të njohur emrat e komunistëve *prishtinas*, *gjakovarë*, *shkodranë* e *tiranas*, të cilët e realizuan atentatin.

Sipas autorëve me bindje të forta enveriste dhe mbrojtës të *LANÇSH-së*, bashkëkohës dhe njohës të ngjarjes: *Shaban Ruka* dhe *Kadri Dingu*, në librin “*Tirana e aksioneve dhe barrikadave (1939-1944)*, *Tiranë më 2003*, kanë konstatuar: “*Më 28 Tetor 1943 u bë atentati kundër Iljaz Agushit, ish-zëvendës Kryeministër të qeverisë kuislinge, i cili kishte marrë pjesë kundër lëvizjes antifashiste Nac.-Çl. Ekzekutimi i tij u bë nga katër gueriles, dy hynë brenda në shtëpinë e tij ku e goditën me tre plumba, ndërsa guerilët e tjerë qëndruan jashtë duke ruajtur rrugën e kalimit meqë afër ndërtesës ku ai banonte (pallatet e lanës) ishte vendosur një repart i Gestapos Gjermane. Aksionin e kryen Bujar Hoxha e Shahin Gjashta*”.

Dy konstatime nuk qëndrojnë: data e vrasjes dhe e dhëna se Iljazi “*kishte marrë pjesë kundër lëvizjes antifashiste Nac.-Çl*”. Dihet saktë se njëri ndër vrasësit kosovar ishte komunisti gjakovar *Ymer Pula* dhe nxënësi *tiranas*, “*i Debatikut*”, shumë i ri, *O.K. Shërbëtorja e Iljazit* dhe mysafiri i tij, dibrani *Ismail Hysi*, e kanë njohur mirë kallauzin, *Bujar Hoxha*, ilake dhe nëpunës i *Iljazit* në ministri, ndaj ia hapën derën si njeriut të tyre, kurse atentatori ka qenë i panjohur për ta. Vetë *Bujar Hoxha*, më 28 nëntor 1992, në *Vlorë*, pranoi se në banesën e *Iljazit* kishte shkuar me *Ymer Pulën*. Se *Ymer Pula* ishte njëri ndër atentatorët ndaj *Iljazit* e dinë shumë bashkëkohës të tij komunistë kosovarë.

Në *Raportin e Prokurorisë Mbretërore për Ministrinë e Drejtësisë*, më 30 tetor 1943, thuhej: “*Kemi nderin t’u njoftojmë se më datën 27 tetor 1943, në orën 18, dy njerëz të panjoftun kanë hyrë në banesën e ish-Ministrit Punëve Botore Iljaz Agushi lindun në Prishtinë dhe banues në Tiranë dhe e kanë vrarë vdekun tue i dhanë gjashtë plagë, gjithashtu kanë tentue dhe kontra (ish)Federalit të Prishtinës, z. Ismail Hysit, por pa dam. Zavendës Prokuror’ i Shtetit, Kemail*”.

Vrasjen e *Iljaz Haxhi Agushit* e mori mbi vete, pa vonuar, *Shtabi i Përgjithshëm i Aradheve Partizane të Kosmetit*, i cili informonte: “*Tiranë, 28 tetor. Dora e drejtësisë popullore ra mbi tradhtarin e Kosovës, Iljaz Agushin(...). Tradhtari numër një i ka pague me kokën e vet të gjitha krimet. Shokët e tij le të mendojnë mirë. Nëse vazhdojnë rrugën e tij, do*

t'i gjejë edhe ata fati i njejtë...!" Pra, data 28 është ajo e raportimin që i bëri Ymer Pula eprorit të tij, komandantit *Fadil Hoxha*. Dhe, në mars të vitit 1944, *Organizata e PKJ-së së Kosmetit* e informonte *KQ të PKJ-së* se "*Në ballë të reaksionit shqiptar deri tashti frikë ka qenë ministri Iljaz Agushi, i cili u vra*".

Vrasja e *Iljaz Haxhi Agushit* pllakosi zi kombëtare në mbarë arealin e *Shqipërisë Etnike*. Vetë *Iljazin*, për të gjallë të tij, shumë miq, veçanërisht nga korriku i vitit 1943, e këshillonin të ruhej se mund të vritej nga komunistët. Mirëpo, *Burri i Dheut shqiptar*, pa hezitim, ua kthente: "*Nuk besoj se mund të ketë shqiptar, i cili do të ngre gishtin në mua...!*" Ai nisej nga fakti se jetën dhe pasjen ua kishte kushtuar kombit, *Shqipërisë tërësore*, lirisë së saj, pa rreshtim partiak. *Iljazi* njohu për parti vetëm shqiptarinë, vetëm *Shqipërinë*. Ai ishte edhe poet i zjarhtë. Shkroi në gjuhën turke dhe ndonjë varg edhe në gjuhën shqipe. Mbi tavolinën e tij të punës policia gjeti edhe dy vargje të *Patër Gjergj Fishtës*, kredo e betim për aktivitetin jetësor politik e luftarak të *Iljaz Agushit*: "*Ma mirë dekë nën dhe m'u kja/ Se për të gjallë me mbet nën shkja!*", të shkruara me dorën e *Marie Shllakut*, ish-punëtore teknike e *Patër Fishtës në Qele*, nëpunëse e *Iljaz Agushit* në *Ministrinë e Punëve Botore*, më vonë e *Xhafer Devës*, bashkëluftëtare e *Ukë Sadikut* dhe bashkëvepruese politike e luftarake e profesor *Ymer Berishës - Orleanë shqiptare*, dëshmore e Organizatës së "*Besës Kombëtare*" për *Shqipërinë Etnike*, për krah *Ymerit* e *Ukës*, mbështetës të *Iljaz Agushit*.

Trupin e pajetë të *Apostullit të Shqipërisë Etnike* e sollën në *Prishtinë*, më 29 tetor, bashkëpunëtorët më besnikë, *Avni Zajmi* e *Maliq Koçuri*. Në dy anët e xhadesë, veçanërisht nga *Kukësi* deri në *Prishtinë*, populli e priti, gardh i gjallë në të dyja anët. Në *Prizren*, në *Therandë*, në *Carralevë*, në *Lypian*, populli ndali kamionetën dhe i bëri homazh. Para arkivolit i valonte *Flamuri Kombëtar*. Obligimin fetar kufomës së *Iljazit* ia kreu *Mulla Ali Rusha* i shquar për shqiptarizëm. *Iljaz Aga* do të përcillet në *Varreza* me homazh ushtarak të burrështetasit. Do të varroset aty ku, më 20 nëntor 2003, ia përruam *Monumentin mbivarrezor modest*, por me simbolikën që e meriton vepra e *Iljaz Haxhi Agushit* dhe *Atdheu Shqipëri* që ende po lëngon nga copëtimet e dhunshme. Aty ishte paria shqiptare popullore, intelektualët dhe ushtarakët patriotë nga mbarë areali etnik dhe historik i *Shqipërisë*.

Para rreth 200 hoxhallarëve nga mbarë rajoni shqiptar i *Kosovës së Liruar*, qëndronte mësuesi i atdhetarisë shqiptare të *Prishtinës*, *Shejh Mehmet Sezai*, kurse imamin e *Garnizonit IV të Ushtrisë së Mbretnisë*

Shqiptare, Komandantin legjendar të *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës Lindore*, *Mulla Idris Gjilanin*, e shoqëronin kolonel *Rexhep Gjilani* dhe kapitenët: *Mark Dredha* dhe *Shefqet Bylykbashi*. *Mulla Idrisi*, vështirë i përsëritshëm në tokën arbërore, në *Fjalën* përmortore për *Iljaz Agushin*, midis tjerash, e quajti *Dëshmor* dhe njëkohësisht *Njeriun më paqësor*, i cili me *këshillë*, *me penë*, *me para* dhe *me pushkë*, u përpoq të ribashkonte *Shqipërinë*. E përmbylli fjalën me kërkesën historike: “*Dhashtë Zoti që, me varrosjen e trupit të Iljaz Agushit, të mos varroset edhe trupi i Shqipërisë Etnike, që e bëri Iljazi, - Fisniku i atdheut dhe i fesë, një yll që kurrë nuk do të fiket, sepse jetoi, u përpoq dhe u bë shehit i Vatanit...!*”

Kjo dua e të *Madhit* mësues të atdhetarisë shqiptare, më detyroi, si një amanet i pashkelshëm, që të koka e varrit të *Iljaz Agushit* të gdhendi në granit *Hartën e Shqipërisë Etnike*, së cilës aktualisht po i nënshkruhet copëtimi përfundimisht edhe me pjesëmarrjen e shqipfolësve në emër të Kosovës e të kombit shqiptar?!

Në *Kryeshnoshje* (Të pamën) për *Iljazin*, *Ministri i Brendshëm i Mbretnisë Shqiptare*, i rrepti *Xahafer Deva*, midis tjerash, do të konstatojë: “*Në Monumentin për Shqipërinë e lirë, emri i Iljaz Agushit ka për t’u shënuar me germa t’arta...!*”

Por, këto vlera dhe këto mesazhë të qenies shqiptare të *Iljaz Haxhi Agushit* nuk mund t’i duronte *Organizata e PKJ-së*. Dhe, derisa komandanti i partizanëve të *Kosmetit*, në prill të vitit 1944, prapë i kërcënonte patriotët shqiptarë “*se do të vriten të gjithë ata që do të ndjekin rrugën e Iljaz Agushit!*”, një *Sulejman Omer Hajro* i *Fadil Hoxhës*, alias *Pvle Joviçeviq* (një si *Rashid Efendia* alias kap. *Rasha Pantiq* i *Isa Boletinit*, përkatësisht një si *Bajro Efendia* alias kap. *Bozha Simiq* i *Idriz Seferit*), i kërcënonte me vdekje pasardhësit ideologjikë të “*tradhtarëve shqiptarë; Sefedin, Rifat e Xhevat Begollit, të Iljaz Agushit, të Ferat Dragës dhe të bejlerëve të tjerë*”.

Koha e vërtetoi se *hoxhët kominternistë* dhe *joviqët albanofobë*, nuk ishin mahitur. Të dhënat vërtetojnë se deri me dënimin me vdekje të amazonës shqiptare, *Marie Shllakut*, më 1946, në male të Kosovës që kullonte gjak, *OZN-a* dhe *UNÇJ-a* likuiduan: me çekanë, me thikë e me plumb rreth 860 ish-bashkëveprimtarë politikë të *Iljaz Haxhi Agushit*: krerë popullorë, ushtarakë, ulema, pjesëtarë të *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës*, veprimtarë, luftëtarë e komandantë të *Organizatës Nacionale Demokratike Shqiptare*, të “*Besës Kombëtare*” dhe të *Lëvizjes për Lirinë e Tokave Shqiptare* që i lidhi dy të parat në një. Në Prishtinë, në ditët

e para të ripushtimit serb komunisto-çetnik, pas 19 nëntorit 1944, ndër të parët u arrestuan udhëheqësit e *Degës së Lidhjes së Dytë të Prizrenit*: i vëllai i madh i *Iljazit*, *Mustafë Haxhi Agushi*, *Mark Stak Mirdita*, madhor i kombit, *Shyqyri be Ramadani* (pronari i tokës ku sot është *Gjimnazi "Xhevdet Doda"* e disa dhjetëra prishtinas të tjerë, që ishin në lidhje veprimtarie politike kombëtare me *Iljaz Agushin*, të cilëve ua humbën varret në "*Tauk Bashqe*".

Për burgosjet dhe pushkatimet pa gjyq, në Prishtinë dhe në Kosovë, la të dhëna poetike, shumë të rëndësishme, kushërira e parë e *Iljaz Agushit*, *Iffet Murat Agushi* (1922- 25 mars 1995), e rritur dhe e shkolluar osmanisht, frëngjisht dhe shqip, nga *Iljazi* më vëllezërit. Poetja shqiptare në gjuhën turke, *Iffet Agushi*, vargjet e para i shkroi më 1937, nën përkujdesjen e *Iljazit*, poet, në një kohë kur shqipja ishte e ndaluar më shumë se topi për shqiptarët. Këtu të mjaftohemi vetëm me pak vargje. Nisemi nga refreni i poemës: "*Kosovë mallëngjyese*", shkruar më 25 shtator 1945, në *Kursin Pedagogjik të Shkupit*, për mësues të shollës shqipe: "*Oj Kosovë, oj fushë krenare, e përgjakur në çdo anë...!*" Dhe, më 27 tetor 1945, si veprimtare shumë e rëndësishme e *Organizatës së NDSH-së*, e vetmja femër si e tillë në Kosovë, lëshonte kushtrimin për rininë patriotike: "*Zgjohuni, atdheu i pret bijtë e vet,/ atdheu ka etje për gjak,/ u thërret në ndihmë. Çka të pritni më!*" Sepse "*Nga ana e djathtë, nga ana e majtë/ Ndihet krisma e mitralozave që kositin zemrat./ Ndihen tingujt e kazmave që hapin varre të reja. /Armiku i zi zgërdhihet pa fije turpi,/ është çmendur sllavi barbar...!*"

Dhe, më 20 korrik 1946, në vigjilje të *Kongresit të Tretë të Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare (Kongresi III i Ballit Kombëtar)* në *Blinajë*, si veprimtare dhe korriere e *LpLTSH-së* në itinerarin: *Prishtinë – Drenicë - Shkup* (Ambasada e Turqisë), *Iffeti* tashti i thërriste Kosovës: "*Mos u shqetëso. Rri e lirë./ ka kush ta zgjatë dorën/ tashmë jemi zgjuar*" dhe përfundonte: "*Rinia është shpëtim yt/ Kosovë e pafat./ Malet tua u veshën me gjakun e derdhur./ Këtë zinxhir do t'a këpusin/ Vetëm duart t'ua të hekurta, Kosovë!?*"

Në këtë digresion kemi dëshminë për mësimin dhe për amanetin e *Iljaz Haxhi Agushit* për brezat shqiptar. *Iffeti* shkoi në kursin pedagogjik për të plotësuar amanetin e *Iljaz Agushit*: "*Iffet, vetëm mësimi i shqipes të bën shqiptare!*"

Dhe, mund të pyesim: Sikur ato qindra vargje poetike të *Iffetit* t'ishin shqip, çka do të ndodhte me autoren, disa herë në duar të *OZN-es* dhe të *UDB-es*?! Fëmijet e *Mustafës* dhe të *Iljazit*, i vëllai *Jusufi* dhe

motra Behixhe, e agushë të tjerë, do të degdisen në Tiranë, në Stamboll dhe në Itali, me identitet dhe dinjitet të nëpërkëmbur, çdo kund, si “turq” në Stamboll e si “kosovar” në Tiranë. Vetëm *Nëna Mejrem*, e bija e personalitetit të shquar *Ali Efendisë*, prishtinas i njohur, nguli këmbë: “*Djemtë më kanë rënë për Kosovën. Kurrë nuk do ta lëshojë. Trupi im dua të më prehet pranë Varrit të Iljazit...!*”

Pushteti komunist *Nënë Mejrem*in e nxori nga *Saraji i vet*, sot *Shkolla e Mesme Teknike “28 Nëntor”* vend i trashëguar nga i ati dhe e ndërtuar në emër të saj, *ngritur me 1938/39*. *Nënëloken shqiptare* të djallërisë patriotike prishtinase nuk e lanë as në *Pallatin e Iljaz Haxhi Agushit*, ku aktualisht është *Televizioni Shtetëror i Kosovës*. Pushteti ushtarak jugosllav, më 1946, konfiskoi qind për qind pasurinë e të bijve të *Haxhi Xhemail Agushit*, pra, të *Mustafës*, të *Iljazit* dhe të *Jusufit* (vdiq në ekzil), i kallë me mallin për Kosovën.

Nënëmadhe *Mejremi* mbylli sytë, më 1948, në mjerim të madh. As nuk u varros në përpikëri me amanetin. Varrosja publike pranë varrit të *Iljazit* do të ishte yshtje për UDB-në kundër monumentit mbivarrëz të *Iljaz Haxhi Agushit*, të cilin ia ngriti i vëllai, *Jusufi*, para nëntorit të dhur 1944, me tekstin letrar osmanisht, shumë madhështor, shumë përmbajtjesor historik, të shkruar nga myderrizi i famshëm, *Sahit Efendi Shkupi*, ish-deputeti i Kosovës për *Shkupin* në *Parlamentin e Perandorisë Osmane*, bashkëveprimtar politik i *Hasan Prishtinës* dhe i *Nexhib Dragës*, dhe i prangosur me ta në *Kalemegdan*, nga fundi i nëntorit 1912. *Sahit Efendinë* e likuidoi UDB-ja në *Kazamatin e Idrizovës*, më 1946.

Këtë *Memorial mbivarrëz*, dhunë historike për *Apostullin e Shqipërisë Etnike* dhe për shqiptarësinë e *Prishtinës* dhe të *Kosovës historike*, nuk pata guxim ta hiqja, ta zhbëja, sepse historia nuk abortohet, e aq më tepër pjesa e përgjakur e saj.

Vërtet, *Apostulli i Shqipërisë Etnike*, *Iljaz Haxhi Agushi* në periudhën e sundimit monist kominternist në *arealin e Shqipërisë Etnike*, i bëri dy jetë, diametralisht të kundërta, jetën popullore të admiruar dhe jetën historiografike të politizuar.

Vërtet, në historiografinë zyrtare shqiptare të Tiranës, *Iljaz Agushi* u denoncua si “*ministër kuisling*”, “*armik i popullit*”, i likuiduar nga një-siti partizan gueril i Tiranës. Emri i tij në këtë historiografi nuk është lakuar më shumë dhe as shumë herë. Ndërkaq, në murin e njërës nga “*Pallatet e Shallvareve*” (te *Lumi Lana*), së paku deri më 9 maj 1993, ishte mbishkrimi në bronz: “*Këtu me 28.X.1943 Nje nga njesitet guerile në Tiranë vrau nje nga tradhetaret e armikun e popullit, ish-nenkryemi-*

nistrin e qeverisë tradhëtare”(?!?!). Kërkova nga pasardhësit e Iljazit të mos hiqej: “*Le të mbetet si një njollë e prekshme në ndërgjegjen shqiptare kominterniste...!*”

Në Tiranë e gjetkë në Shqipërinë Londineze, nga viti 1980, sa herë kam pasur mundësi për qasje në masat, për Iljaz Agushin kam shënuar dhjetëra përshtypje miradije, nga radhët e nacionalistëve dhe të komunistëve. Është personaliteti i vetëm në qeveritë shqiptare të Luftës së Dytë Botërore, për të cilin nuk mund të dëgjohet asnjë vërejtje, përpos: “...shqipen e fliste me theks turqisht...!” Të parët, nacionalistët, shprehin indignatë për vrasjen e *Një shqiptari të kulluar*, kurse të dytit, kominternistët, ndihen si të marruar për vrasjen e Iljazit.

Opinionet e të parëve, të nacionalistëve për jetën dhe veprimtarinë politike e ndërtimore të fisme të Iljaz Agushit në Tiranë, që jetonte në kujtesën historike të masave, si opinion popullor i nëntokës kombëtare të Shqipërisë komuniste, mund të pasqyrohen vetëm me disidentizmin e Tafil Ahmet Boletinit, antifashist, nëpunës e prefekt në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ideologjikisht i afërt me Iljaz Agushin: “*Dajë, në qoftë së ka pas person patriot qi e ka deshtë shqiptarizmin, qi e ka deshtë Shqipninë, qi e ka deshtë Kosovën, asht Iljaz Agushi. Se kush vuni dorë mbi te ka ba krimin ma të madh ndaj kombit shqiptar...!*”- ia kishte përsëritur, shumë herë, Enver Dajçit, kuadër politik i ushtrisë partizane në Kosovë e në Shqipëri, themelues i “*Aradhës Partizane të Rakoshit*” në verë 1944.

Për opinionin e të dytëve, të komunistëve, të mjaftohemi këtu vetëm me një konstatim shumë të përmbledhur e simbolik, të ekonomistit tiranas, Z. Beqir Hushi, luftëtar i Brigadës III të UNÇSH-së më 1943, sekretar partie i Rrethit të Durrësit (që përfshinte edhe Shijakun, Matin, Burrelin), pas Luftës, inspektor në Ministrinë e Bujqësisë (të Hysni Kapos). Në vitet 60 ndodhi të bëhej baxhanak me nipin e Iljazit: “*Për Iljaz Agushin pyeta disa shokë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe më thanë: ‘E mori për asgjë ujët e turbullt, shkoi si kovë pusi - pa asgjë’*”(Durrës, 17.07.2006)!?!.

Ndërkaq, opinionin komunist shqiptar i Kosovës mund të thuhet se është përmbledhur në konstatimin në “*Kujtime*” e Ismet Shaqirit, bashkëveprimtar politik e luftarak i Ymer Pulës: “*Mbi Iljaz Agushin ra “dora hakmarrëse partizane”!?!*”

Çka mund të bënin historianët, në përgjithësi, për ndriçimin e jetës dhe të veprimtarisë politike e kombëtare të Iljaz Agushit, në rrethana të ekzistimit të një anatemi të tillë politik, në kushte të robërisë komi-

nterniste titiste dhe enveriste, kur jeta dhe vepra e *Iljaz Agushit* ishin tabu politike të dënueshme?!

Opinion i popullor për madhësinë e *Iljaz Agushit* në Kosovën e robëruar, dhe në mërgatën politike patriotike antijugosllave të Kosovës në botë, mund të përvijohet me bindjen e urtakut popullor, *Mujë Loshi të Drenicës*, i cili gjatë *Lëvizjes së Pajtimit Kombëtar 1990-1992*, shpesh ia përsëriste rinisë paqekrijuese: “*Populli kurrë nuk do t’i harrojë Burrat e Dheut si Iljaz Agushin me shokët, që u përpoqën, luftuan dhe ranë për Shqipërinë, ku bukës i thonë bukë, e ujit ujë...!*” Ndërkaq, i pathyeshmi ushtar i thjeshtë i *Shqipërisë Etnike*, *Hysen Tërpeza*, për idol kishte *Iljaz Agushin*. Sipas Tij, “*Iljazi ishte patriot i kulluar, më i madhi dhe më i ndershmi Burrë i Kosovës që njoha...*”

Unë, njohës relativisht i mirë i historisë kombëtare të pashkruar, mund të konstatoj: *Iljaz Agushi* është personalitet i lagjes së Skënderbeut, *Myderriz Ymer Prizrenit*, *Mulla Haxhi Zekës* dhe *Hasan Prishtinës*. Legjenda *Adem Jashari* ha bukë veç, sepse heroizmi i tij ia ktheu *Shqipërisë Etnike* këta Burra të Dheut, vlerë sublime të atdhetarisë shqiptare. Vërtet, *Betimi i UÇK-së* është vetëm sublimim i kërkesave, i përpjekjeve dhe i betimit të pashkelshëm të *Iljaz Agushit*, amanet për brezat shqiptarë.

Duke përfunduar, e shoh të udhës të sjell një kërkesë timen jetike për *Iljaz Haxhi Agushin*. Më 22 tetor 1994 e përfundova dhe e botova shkrimin e gjatë, me titull: “*Iljaz Agushi – Apostulli i Shqipërisë Etnike*”, të cilin e përmbylla me konstatimin: “*Shkenca i ka borxh Iljaz Agushit një dëshmi më të plotë – Një monografi historike shkencore, kurse Qeveria Shqiptare ta laurojë Iljaz Agushin me gradën më të lartë që meritojnë Dishepujt e Shqipërisë Etnike...!*” Ndërkaq shkrimin: “*Fanar në Oqeanin shqiptar të trazuar*”, të botuar më 1996, në 53-vjetorin e vrasjes, e përmbylla me kërkesën: “*Ftojme Presidencën dhe Parlamentin – Komisionin për Shënimin e Datave Historike dhe Dekorimin e Personaliteteve Kombëtare që për Ditën e Flamurit, 28 Nëntor 1996, ta Dekorojë Martirin e Apostullin e Shqipërisë Etnike, Iljaz Haxhi Agushin (1903-1943) Me medaljen më të lartë të kombit shqiptar!*”

Këtë kërkesë e mbajmë të gjallë, gjithmonë, përderisa Institucionet shtetërore të *Shqipërisë* dhe të *Kosovës* nuk do ta plotësojnë meritueshëm këtë kërkesë jetësore për kombin shqiptar të copëtuar.

I ndritshmi *Iljaz Haxhi Agushi* është yll në qiellin e *Shqipërisë* (ku bukës i thonë bukë dhe ku ujit i thonë ujë) që nuk shuhet kurrë!